



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:289260

Datë: 08.06.2022

Numri i dokumentit: 03111890

Pml.nr.205/2022

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka-kryetare e kolegjit, Nesrin Lushta e Agim Maliqi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurve J.K. nga fshati V., komuna e Sh. dhe S.S. nga G., për shkak të veprave penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par.1 lidhur me par.2.7 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) duke vendosur sipas kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të tyre, të paraqitura kundër urdhrit të Gjykatës Themelore në Ferizaj nr.2021:289260 të datës 20.01.2022, për ngrirjen afatgjate të aseteve-llogarive bankare dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.222/2022 të datës 23.03.2022., në seancën e mbajtur më datë 31.05.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHEN si të papranueshme kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësve të pandehurve J.K. dhe S.S. të ushtruara kundër urdhrit të Gjykatës Themelore në Ferizaj nr.2021:289260 të datës 20.01.2022 për ngrirjen afatgjate të aseteve-llogarive bankare dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.222/2022 të datës 23.03.2022.

A r s y e t i m

Me urdhrin e Gjykatës Themelore në Ferizaj nr.2021:289260 të datës 20.01.2022 për ngrirjen afatgjate të aseteve-llogarive bankare, është urdhëruar ngrirja e aseteve-llogarive bankare të pandehurve J.K. dhe S.S. (dhe ca të pandehurve tjerë) ndaj të cilëve në atë gjykatë zhvillohet procedurë penale për veprat penale dhënia e ndihmës kryesve pas kryerjes së veprës penale nga neni 388 par.1 lidhur me par.2.7 të KPRK.

Duke vendosur sipas ankesave të paraqitura, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin e PN.nr.222/2022 e datës 23.03.2022 të njëjtat i ka refuzuar si të pabazuara.

Kundër këtyre vendimeve, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë kanë ushtruar mbrojtësit e të pandehurve, avokatët Miro Delević dhe Predrag Miljković, për shkak të shkeljes së dispozitës

së nenit 264 par.1 lidhur me nenin 90 par.1 të KPPK, me propozim që të ndryshohen ashtu që të refuzohet propozimi i Prokurorisë Themelore në Ferizaj për dhënien e këtij urdhëri.

Prokurori i Shtetit, me parashtrësën KMLP.II.nr.128/22 e datës 23.05.2022 ka propozuar që kërkesat të hudhen si të palejuara.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 të KPPK vlerësoi pranueshmërinë e kërkesave dhe konstatoi se:

- kërkesat nuk janë të pranueshme.

Gjykata Supreme konstatojë se kërkesat janë të papranueshme për faktin se, sipas dispozitës së nenit 432 par.1 të KPPK kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimit gjyqësor të *formës së prerë* ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në *formë të prerë*. Ndërkaq, sipas dispozitës së nenit 432 par.4 të KPPK, gjatë procedurës penale e cila *nuk ka përfunduar në formë të prerë*, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e *paraburgimit*.

Në çështjen konkrete procedura penale ende nuk ka përfunduar në formë të prerë, por është marrë një urdhër gjatë zhvillimit të procedurës penale ashtu që sipas dispozitës së lartë cekur ligjore, në këtë fazë të procedurës për një vendim të tillë, nuk ekziston mundësia ligjore për ushtrimin e këtij mjeti të jashtëzakonshëm juridik.

Për arsyet e cekura më lartë, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u hodh si e papranueshme në kuptim të nenit 435 par.2 të KPPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
Pml.nr.205/2022, më datë 31.05.2022

Procesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka